




BASHKIA DURRES

## RELACION ARKITEKTOKNIK

**OBJEKTI: RIKONSTRUKSION KOVIKTI SHKOLLA E FISKULTURES**



SHKURT 2019

## RELACION ARKITEKTONIK

Konvikteti i shkolles se fiskultures “Benardina Qeraxhi” ndodhet brenda territorit te shkolles me adrese lagja 16, rruga “Mujo Ulqinaku”, ne qytetin e Durresit. Eshte nje objekt 4 katesh.

### GJENDJA E KZISTUESE



### Vlerësimi fizik i objektit - Problematika

- Suvatimet e mureve jane te demtuara
- Mungon sistemi kapot
- Ka prani te lageshtise

- Dyert dhe dritaret janë të amortizuara
- Sistemi i kanalizimeve nuk funksionon mire
- Ndjehet nevoja për riformulim të hapësirave, përmiresim të planimetrisë
- Rreth e qark konviktit nuk eshte e sistemuar
- Sistemi elektrik eshte i amortizuar
- Sistemi i ngrohjes mungon
- Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit mungon
- Muri rrethues ekzistues eshte i amortizuar dhe ne një pjese mungon.

Konviki ka nevoje per një nderhyrje rrenjesore totale ne ambientet e tij, nyjet sanitare dhe ne te gjithe ambientet e tjera ndihmëse.

## PERSHKRIMI I PROJEKTIT.

Projekti për rikonstruksionin e palestres është hartuar mbi bazën e detyrës së projektimit te vene ne dispozicion nga BASHKIA DURRES .

Nga ana fizike sheshi per nderhyrje, ka një relief uniformisht te sheshte dhe një forme gjometrike te rregullt .Plani i palestres eshte i orientuar nga perendimi.

Duke pasur ne konsiderate kerkesat e hartuara nga bashkia, nevojat e mundesite aktuale ne vend, ne propozojme qe nderhyrjet ne konvikt te jene te tipit teknike, ne lidhje me sistemin elektrik dhe hidromekanik, nderkohe nderhyrjet ne planimetrine jane per te krijuar kushte sa me te pershatshme per nxenesit e shkolles, duke krijuar kushte bashkekohore.

Ne planin e konviktit jane shtuar nyje hidro-sanitare ne cdo dhome.Ne katin e pare eshte parashikuar një ambient per biblioteke.

Propozohet prishja e disa mureve ekzistues ndares dhe ndertimi i te rinjve duke krijuar hapesira te reja. Duke pare planin vihet re qarte riorganizimi funksional i hapesirave te ketij kati. Kati i dyte dhe i trete qe aktualisht nuk jane funksionale do te behen funksional me një planimetri uniform me katin e pare.Secili kat ka nga 25 dhoma. Nje dhome eshte menduar per dy nxenes.Ne cdo kat eshte parashikuar nga një ambient per kujdestaret.

Ne kete menyre jane marre masat per permiresimin e kushteve baze per permiresimin e cilesise se ndertesës.

### *Ambientet sanitare*

Nyjet sanitare jane te vecanta per personelin dhe per cdo dhome eshte menduar një nyje hidro-sanitare.Eshte menduar te sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, dhe dushe.Për këtë arsyе është parë mundësia e realizimit të rrjetit të nevojshëm hidraulik .

### *Dyer dhe dritare*

Dyert e rinovuara do te jene tamburato dhe te pajisura me kase druri.Dyert e nyjeve hidrosanitareve do te jene duralumin me xham. Persa i perket dritareve do të janë plastike dopio-xham. Dyert e jashtme eshte menduar te jene metalike.

### *Suvatimet dhe veshja e mureve te jashtme*

Objekti qe do te rikostruktohet do tē suvatohet nga brenda dhe jashtë. Muret e jashtme do te vishen me kapotë termike (hidroizolim + termoizolim antizjarr + suvatim me rrjetë) sipas specifikimeve teknike, pasi paraqesin dhe lageshti. Përsa i përket suvitimeve te jashtme ajo do jete një pjese e rendesishme dekorative e objektit.

### ***Shkallët, korridoret shtresat***

Shkallet do te vishen me pllaka mermeli 3 dhe 2 cm.

Plakat ekzistuese tē dyshemesë së vjeter së bashku me llaçin e vjetër do tē zevendesohen nga shtresa e re e dyshemese, me pllaka, duke patur parasysh rinivelimin e saj me llaççimento si dhe me shtresat e nevojshme izoluese ne rastin e ambjenteve qe e nevojtin ate.

Projekti parashikon zevendesim te shtresave izoluese te tarraces dhe ullukeve, pasi jane te demtuara.

Oborri i jashtem eshte konceptuar si pjese organike dhe funksionale per shkollen dhe konviktin. Eshte parashikuar ndertimi i nje fushe minifutbolli per stervitje pasi i mungonte shkolles. Gjithashtu eshte parashikuar ndertimi i nje piste vrapit me gjashte korsi, rrith e qark fushes se futbollit dhe konviktit, si dhe nje piste kercimi per stervitje. Ndersa pjesa rrith e qark konviktit do te sistemohet e shtrohet me pllaka veteshtenguese dhe gjelberim. Drenazhimi i ujrate nentokesore eshte zgjidhur duke i dhene pjerresine e duhur sheshit si dhe me puseta shimbledhese e tubacione kub e drenazhi.

Rendesi te veçante ne projekt i eshte kushtuar ndriçimit. Ndriçimi artificial eshte parashikuar i tille qe te siguroje kushtet optimal te ndriçimit ne rastet e mungeses se drites natyrale.

Te gjitha dritaret e ambienteve jane parashikuar me dopio xham per efekt termoizolimi.

Projekti parashikon dhe mbrojtje kundra zjarrit si ne aspektin e specifikimeve te materialeve te perdonura ashtu edhe ne aspektin e evakuimit dhe masave qe perdoren per fikjen e zjarrit.

- 1-Propozohet heqja e dyerve ekzistuese dhe zevendesimi i tyre me dyer te reja.
- 2-Propozohet heqja e dritareve ekzistuese dhe zevendesimi i tyre me dritare te reja.
- 3-Propozohet prishja e shtresave,te te gjithe ambjenteve dhe realizimi i tyre te reja sipas projektit.
- 4-Propozojme zevendesimin i shtreeses hidroizoluese te tarraces dhe zevendesimi me shtrese te re
- 5-Prishja e suvitimeve ekzistuese dhe zevendesimi me suva te re
- 6-Lyerja me boje hidroplastike dhe sistemi kapot
- 7-Ndertimi i ri i rrjetit elektrik
- 8-Ndertimi i ri i rrjetit hidraulik dhe sistemit te ngrohjes
- 9-Instalimi i tokezimit mbrojtës
- 10-Instalimi i sistemit MNZ
- 11-F.V. ndriçues
- 12-Sistemimi i territorit te jashtem
- 13-Ndertim i murit rrethues
- 14-Ndertimi i fushes sportive te futbollit dhe pistes se vraptit

### Sistemi i furnizimit te ujit sanitar (i ftohte dhe i ngrohte )

Stacioni i pompave te ujit eshte pjesa me rendesishme e sistemit. Ai eshte parashikuar te funksionoje me pompa dhe rezervuare parametrat e te cileve jane llogaritur ne perputhje me diagramat ditore te nevojave per uje dhe konfiguracionit te rrjetit . Eshte parashikuar dhe ambienti teknik ne katin perdhe dhe dy ambiente ndihmese jashtje godines.

### Sistemi i shpërndarjes te ujit sanitar

Sistemi i ujit te ngrohte sanitar do te sherbeje per te siguruar ujin e ftohte dhe te ngrohte nga stacioni i pompimit tek linjat kryesore dhe mbas kesaj te siguroje shperndarjen e ujit ne pajisjet e ambienteve sanitare. Sitemi i tubove te ujit sanitar do te plotesoje kerkesat e normave dhe standarteve te percaktuar dhe seleksionuar qysh ne fazen e projektimit prej stafit inxhinierik si dhe te kerkesave paraprake te investitorit. Tubo e ketij sistemi jane ndare ne funsion te materialit te tyre si me poshte:

- Distanca standarde : 6 m
- Prova hidraulike : 50 bar
- Siperfaqia e zeze

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tubacioneve te ujit ne objekt, duhet te behen dhe sipas kerkesave teknike te supervizorit dhe te projektit.

### SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT

Cdo godine banimi apo shërbimesh duhet te plotesoje kushtet e caktuara te sigurise ku nje nder to eshte edhe sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit, i cili ndahet ne dy tipe:

#### 1. Sistemi i Pasiv

Sistemi pasiv konsiston ne materialet teknike te cilat instalohen gjate ndertimit te cilat mund te jene materiale kunder zjarrit, ventiliimi i hapësirave te perbashketa ndaj tymrave te zjarrit ne rastet e renies se zjarrit si dhe paracaktimi ne fazen e projektimit te daljeve te emergences.

#### 2. Sistemi Aktiv

Ky sistem perbehet nga impiantet e mbrojtjes kunder zjarrit. Keto sisteme mund te jene te tipeve te ndryshme te cilat jane:

- Impianti i mbrojtjes kunder zjarrit me uje
- Impianti i mbrojtjes kunder zjarrit me pluhur
- Impianti i mbrojtjes kunder zjarrit me CO<sub>2</sub>
- Impianti i mbrojtjes kunder zjarrit me halogjene
- Impianti i mbrojtjes kunder zjarrit me aerosol

M.q.se jemi ne nje godine konviki tipologja e impiantit te cilin ne do te përdorim impiantin

e shuarjes se zjarrit me uje (klasa A e zjarrit materiale te ngurte te djegshem). dhe gjithashtu do te perdoret impianti i shuarjes se zjarrit me pluhur ne koridore.

Hidrantet duhet te vendosen ne menyre te tille qe çdo i tille te mbuloj deri 1000 m<sup>2</sup> dhe çdo pike e mbrojtur prej tij nga zjarri te mos jetet me teper se 30 m larg.

### ***Kasetat kunder zjarrit***

Kasetat jane vodosur ne ambientet e brendshme prane hyrjeve te vodosura per te realizuar nje zgjidhje sa me ekonomike, si dhe per te kapur piken me te larte dhe me te larget nga kutia e H/Z.

### ***Tipi i kasetes Kasete antizjarr Dn 45 – Mt 30***

### ***Pompa e furnizimit me uje te hidranave***

Eshe vodosur nje grup i veçante pomash qe ka keto te dhena :

- Prurja: 15m<sup>3</sup> / h
- Prevalanca: 50 mkH2O
- Lidhjet: Ø 2 " / PN 16



### **Sistemi i shkarkimit te ujrate te zeza dhe te shiut**

#### **Dimensionimi**

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te shkarkimit te ujrate te zeza dhe ato te shiut do te kryhet duke marre ne konsiderate te gjithe elementet te percaktues si me poshte:

- Skema e shperndarjes (shkarkimet e brendshme te pajisjeve H/S, kolonat, kolektoret, pusetat);
- Percaktimi i fluksit nominal te shkarkimeve per çdo pajisje H/S;
- Percaktimi i fluksit projektues te shkarkimeve;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te brendshme te ujrate te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e shkarkimeve te kolonave te ujrate te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolonave te balancimit te presionit te ujrate te zeza;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te shkarkimeve te brendshme;
- Vizatimet dhe dimensionimet e tubacioneve te shkarkimit te ujrate te shiut;
- Vizatimet dhe dimensionimet e kolektoreve te jashtem;
- Vizatimet dhe dimensionimet e pusetave te ujrate te zeza.

Dimensionimi i tubove do te jetet ne vartesi te fluksit te llogaritur te ujrate te zeza apo te shirave, shpejtesise se qarkullimit dhe pjeresisi se tyre etj. Shpejtesia duhet te jetet  $1.0 \div 1.2$  m/sec dhe pjerisia e tubove ne kufijtë ( $0.5 \div 0.8$  ) %.


Diametrat dhe trashesite do te jene ne perputhje me te dhenat e projektit. Ne diametrat e jashtem te çdo tubi duhet te jene te stampuar karakteristikat sikurse presioni, fabrika prodhuese, viti i prodhimit etj.

### Materialet e tubave

Per shkarkimet e ujrave do te perdoren tuba plastike PP (polipropilen i termostabilizuar ne temperature te larta) qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove). Ata jane dizenuar ne perputhje me standartin EN 12056.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Tubat e shkarkimit duhet te vendosen ne te gjithe lartesine e nderteses, ne formen e kollonave, ne ato nyje sanitare ku aparatet jane me te grupuara dhe mundesish sa me afer atyre nyjeve qe mbledhin me shume ujera te ndotura dhe ndotje me te medha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh ne çdo kat me ane te tubave te dergimit. Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit duhet te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade. Tubat e shkarkimit mund te shtrohen sic jane parashikuar ne projekt duke mbajtur parasysh kushtet e caktuara per montimin e rrjetit te brendshem te kanalizimeve. Gjatesia e ketyre tubave nuk duhet te jete me teper se 10 m. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur sic eshte paraqitur ne projekt.



### SISTEMI I NGROHJES

Ky objekt eshte i perbere nga zona me tipologji pothuajse te njetate , qe kane te njejtin qellim te perbashket per sa i perket sigurimit te nje komoditeti normal per personat qe banojne ne keto ambiente. Keto kerkesa jane parapare ne propocion me standartet e jeteses si dhe me ndikimin e tyre ne koston e rihabilitimit te objektit.

#### I. Kushtet e projektit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mireqenia fiziologjike) qe mund te sigurojme brenda konviktit jane ne vartesi te destinacionin te perdonimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdonur si referencia per projektin.

Lloji i punimit

Instalimi i rrjetit te ngrohjes

Adresa

Durres

Numri i njesive

1 modul

Destinacioni i perdonimit

Konvikt

Lloji i impiantit

Ngrohje

Sistemi i ngrohjes se godines eshte planifikuar te jete hidronik me ngrohje me radiator Burimi i energjisë do te sigurohet nga njesi qendrore qe ne kete rast eshte kaldaja. Uji i ngrohje do te shperndahet nga rrjeti i tubove te cilet vijne nga ambienti teknik dhe nepermjet

kolonave vertikale dhe magjistraleve te cilat bejne te mundur shpernarjen ne cdo kate. Neper kate jane vendsur disa kolektore nepermjet te cilit behet furnizimi i cdo radiatori.

## **II. Grupet termike**

Kerkesat per ngrohje te objektit jane kalkuluar ne baze te standarteve qe jane ne fuqi ne Shqiperi. Temperatura e ambientit te jashtem eshte perzgjedhur 1°C.

Kapaciteti i kaldajes perballon energjine e nevojshem per ngrohjen e cdo mjedis si dhe humbjet e energjise gjate qarkullimit te ujit ne tubacet shperndares. Kalkulimi i kapacitetit eshte bere ne perputhje me standartet europiane.

Faktoret e mesiperm jane konsideruar duke patur parasysh qe influena e izolimit te tubove mund te varioje ne 5 - 15 % te kapacitetit. Kalkulimet preçize jane bazuar ne normat moderne dhe I kane sherbyer stafit inxhinierik gjate procesit te projektimit per te bere dimensionimin e kaldajes dhe sistemit te ngrohjes ne teresi.

Ngarkesa e pikut per kaldajen eshte percaktuar ne baze te te dhenave te tabelave per ngarkesat e percaktuar per ngrohje.

## **III. Tubacionet e shperndarjes**

Sistemi i ngrohjes eshte ndare ne tre komponente: gjeneratori i nxehtesise, transmetuesit e kesaj nxehtesie (tubot) dhe transmetuesit e nxehtesise qe jane radiatoret.

Sistemi i tubove do te sherbeje per te transmetuar nxehtesine prej kladajes ne terminale dhe do ta ktheje ate perseri ne kaldaje me ndihmen e pompes qarkulluese te cilat jane llogaritur ne varesi te prurjes se ujit te secilit radiator, shpejtesie dhe humbjeve te limituara.

Tubat e sistemit ngrohes duhet te plotesojne kerkesat e standarteve / normave. Ata gjate projektimit zgjidhen prej inxhinierit sipas kerkesave qe u shtrohen atyre.

Tubat e sistemit ngrohes mund te ndahen sipas materialit:

- Materialat e tubave

- Tubot e çeliku pa tegel do te perdoren nga kaldaja deri ne lidhjen me kolektoret.

Dimensionet e tubave te serise mesatare te filetueshme EN 10255 , te zinguar ne te nxehet sipas UNI EN 10240 .

- Gjatësia standarde: 6000 mm (+/- 3%)
  - Marka e tubave pa saldim ( me filetim): EN 10255
  - Trajtimi i sipërfaqes : te zinkuar ne te nxehet EN 10240 A1
  - Temperatura e punës : -10 °C/+110 °C
  - Prova hidraulike : 50 bar
  - Presioni nominal ne temperaturën e ambientit :10 bar
- 
- Tubat plastike (Pex-Al-Pex) jane rezistent kunder korozionit. Ata duhet te vendosen ne vende, ku materialet e lartpermendura nuk mund te vendosen per shkak te korozionit dhe agresivitetit te ujit. Ne rastin konkret at jane perdonur ne dyshemene e te gjithe ambienteve dhe lidhin kolektoret me radiatoret. Duhet kujdesur qe tubat plastike, te plotesojne kerkesat e shtypjes dhe temperatures se nevojshme.

Tubo Polyetileni (Pex-Al-Pex) te retikular Jane perzgjedhur ne perputhje me standarte internationale te kualitetit ISO 9001 or DIN 53457. Keto tubo Jane vendsur ne dyshemet e

ambienteve dhe kane veti te shkelqyera si dhe karshi agjenteve kimike, stabilitet te larte termik, peshe te ulet, humbje te ulta presioni, te thjeshte ne mirembajtje per riparime dhe transport, te thjeshte ne instalim dhe nje jetegjatesi prej mbi 50 vjet .

Vetite termofizike te tubove Pex-Al-Pex jane me poshte si vijon :

- |                           |              |
|---------------------------|--------------|
| • Ashperisa e brendeshme  | 0,007 mm     |
| • Bymimi termik           | 0,43 w/mk    |
| • Koeficienti i zgjerimit | 0,026 mm/m°C |
| • Temperatura e punes     | 95 °C        |
| • Presioni punes          | 10 bar       |
| • Niveli I rrjetezimit    | > 65%        |
| • Rrezja e kurbezimi      | 5 Diametrin  |

## **SISTEMI ELEKTRIK**

Ky projekt permban percaktimet dhe orientime per furnizimin dhe venien ne pune te impianteve elektrike te nevojshme per instalimet elektrike te objektit te godines se objektit. .

Objekt i ketij relacioni teknik jane edhe percaktimet per normat teknike qe jane perdonor ne projektimin e impianteve elektrike te ndare si me poshte.

- Praqitja (vizatimet) e projektit.
- Zgjedhjet dhe procedura per rrjetin elektrik.
- Cilesite e materialeve te zgjedhura.
- Impianti i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- Impianti I tokezimit

Grupi i projektimit.

Ark. Adnand Tocila

Ing. Eni Turkeshi

